



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2018

Njoftim

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 8 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brëndshëm të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin Nr. 141, datë 24.12.2008 dhe nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96 datë.16.07.2016, njoftojme se ditën e premte , datë 03 .08.2018, ora 10 :00 zhvillohet mbledhja e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1. Në lidhje me Memorandumin e Mirëkuptimit mbi Bashkimin e Tregjeve Ditore të Energjisë Elektrike ndërmjet ERE- ZRrE- OST sh.a-KOST(Drejtorite Teknike)
2. Në lidhje me fillimin e procedurave për shqyrtimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të analizës së kosto-përfitimit në përputhje me nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 Gusht 2017 ,që përcakton një Udhëzues mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, me shpjeguesin përkatës(Drejtoritë Teknike)
3. Në lidhje me licensimin e shoqërisë “URADRIN” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.(Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)
4. Në lidhje me fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “MP-HEC “ sh.p.k për liçensim në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “ Niçë” (Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)
5. Fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës së shoqërsë “OSOJA ENERGY” sh.p.k., me nr. 408 Seria P18 K, miratuar me vendimin

e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.05.2017, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Seman 1”, me vendodhje, Sheq Marinas, Topojë, Bashki Fier, me fuqi të instaluar 2MW, (Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)

6. Në lidhje me liçensimin e shoqërisë “ EDIANI “Sh.p.k ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike (Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)
7. Informacion mbi kërkesën e shoqërisë “OSOJA HPP” sh.p.k për shtyrje të afatit të vendimarrjes së bordit të ERE-s (Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)

Kryetari i ERE-s
Petrit AHMETI